

**Prajmer (astar) epoksid kundër ndryshkut, me dy përbërës****Përshkrimi**

EPOXYCOAT-AC është sistem epoksid me ngjyrë, 2 komponentesh, pa tretës. Ofron fortësi të lartë dhe rezistencë ndaj fërkimit. Është jashtëzakonisht rezistent ndaj acideve, alkaleve, produkteve vajguore, tretësve, ujit, ujit të detit etj. Në sipërfaqet metalike ofron mbrojtje të shkëlqyer nga ndryshku.

**Fushat e përdorimit**

EPOXYCOAT-AC aplikohet si shtresë aktive kundër gërryerjes-ndryshkut në sipërfaqe metalike dhe prej çeliku, të cilat do të mbishtrohen me rrëshira epokside EPOXYCOAT-W, EPOXYCOAT, EPOXYCOAT-S ka EPOXYCOAT-VSF. Gjithashtu mund të aplikohet edhe si shtresë përfundimtare për lyerje, përderisa është e pranueshme ngjyra kafe në të kuqe ose gri. Raste karakteristike të aplikimit janë mbrojtja e siloseve, urave metalike, mureve rrethuese (gardheve), çative metalike, tubacioneve, armaturës së hekurit etj.

**Të dhënat teknike**

Baza kimike:	rrëshirë epokside 2 komponentesh
Ngjyrat:	RAL 3009 (kafe në të kuqe) RAL 7040 (gri)
Viskoz:	300 mPa.s në +23°C
Dendësia:	1,40 kg/lit
Raporti i përzierjes (A:B):	100:13,5 sipas peshës
Jetëgjatësia në enë:	rreth 2,5 orë në +20°C
Temperatura minimale e ngurtësimit:	+8°C
Gati për t'u shkelur:	pas 24 orësh në +23°C
Pranon mbishtresë:	pas 3-24 orësh në +23°C
Veti mekanike përfundimtare:	pas 7 ditësh në +23°C
Rezistenca në ngjitje:	> 3 N/mm <sup>2</sup> (kufiri i shkatërrimit të betonit)

Pastrimi i veglave:  
Veglat duhet të pastrohen me kujdes menjëherë pas përdorimit të tyre me tretës SM-12.

**Mënyra e përdorimit****1. Nënshtrësia**

Sipërfaqet që do të shtrohen duhet:

- Të jenë të thata dhe solide.
- Të jenë të pastra, pa materiale që pengojnë ngjitjen si pluhura, materiale të prishura, lëndë yndyrore etj.
- Të jenë të pastruara nga ndryshku ose çdo lloj gërryerje që pengon ngjitjen.

Nënshtrësia përgatitet duke u pastruar me furçë, fërkim, me rërë me presion etj. Në vazhdim sipërfaqja duhet të pastrohet shumë mirë nga pluhurat.

**2. Përzierja e EPOXYCOAT-AC**

Komponentet A (rrëshira) dhe B (ngurtësuesi) janë të ambalazhuara në enë me raport përzierjeje optimal të parapërcaktuar. Sasia e komponentit B shtohet e gjitha në enën me komponentin A. Përzierja e dy komponenteve bëhet për rreth 5 minuta me turjelë (dhrapano) elektrike me rrotullime të ulëta (300 rrot./min.). Është e rëndësishme që përzierja të bëhet dhe në faqet e enës dhe në fundin e saj, që të kemi një shpërndarje uniforme të ngurtësuesit.

**3. Procedura e aplikimit - Konsumi****a) Prajmer (astar) shtresash epokside**

EPOXYCOAT-AC aplikohet me rol, furçë ose spërkatje në dy shtresa. Shtresa e dytë vijon, pasi të thahet shtresa e parë, brenda 24 orësh. Konsumi: 150-200 g/m<sup>2</sup>/ shtresë. Brenda 24 orëve që vijojnë dhe pasi është tharë prajmeri, aplikohet lyerje me bojë epokside EPOXYCOAT-W, EPOXYCOAT, EPOXYCOAT-S ose EPOXYCOAT-VSF.

**b) Bojatisje**

EPOXYCOAT-AC aplikohet me rol, furçë ose spërkatje në 3-4 shtresa. Çdo shtresë vijon, pasi të thahet shtresa e mëparshme, brenda 24 orësh. Konsumi: 150-200 g/m<sup>2</sup>/ shtresë.

# EPOXYCOAT-AC



## Amballazhimi

EPOXYCOAT-AC disponohet në amballazh (A+B) me peshë 3kg dhe 8kg. Komponentet A dhe B janë në raporte përzierjeje të parapërcaktuara sipas peshës

## Magazinimi

Të paktën 12 muaj nga data e prodhimit në enë të mbyllur, në vende të thata dhe të freskëta.

## Shënime

- Koha e përpunimit të sistemeve epokside pakësohet me rritjen e temperaturës së mjedisit.
- EPOXYCOAT-AC përmban tretës. Gjatë aplikimit të tij në vende të mbyllura duhet pasur kujdes i veçantë për ajrosje të mirë.
- Ngjitja midis dy shtresave të njëpasnjëshme mund të influencohet negativisht për shkak të lagështisë ose ndotjeve të ndryshme ndërmjet tyre.
- Sipërfaqet me shtresa epokside duhet që të mbrohen nga lagështia për rreth 4-6 orë pas përfundimit të tyre. Ndikimi i lagështisë mund t'i japë sipërfaqes një nuancë të bardhë ose ta shndërrojë në sipërfaqe ngjitëse. Gjithashtu mund të ndikojë negativisht gjatë ngurtësimit. Shtresa të çngjyrosura ose ngjitëse duhet hiqen me fërkim ose frezim dhe në vazhdim të rishtrohen të reja.
- Në rastet kur ndërmjet dy shtresave të njëpasnjëshme koha që kalon deri në aplikimin e shtresës së dytë është më e madhe se ajo që parashikohet ose kur duam të shtrojmë mbi sipërfaqe të vjetra, duhet që sipërfaqja të pastrohet mirë dhe të fërkohet e gjitha. Në vazhdim aplikohet mbishtresa e re.
- EPOXYCOAT-AC pas ngurtësimit të tij nuk është i dëmshëm për shëndetin.
- Para përdorimit të materialit këshillohuni me udhëzimet për përdorim të sigurt dhe të cilat shkruhen në etiketën e produktit.



2032

ISOMAT S.A.

17<sup>th</sup> km Thessaloniki – Ag. Athanasios  
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag Athanasios, Greece

10

2032-CPR-10.11

DoP No.: EPOXYCOAT-AC/1834-01

EN 1504-7

Reinforcement corrosion protection product for uses other than low performance requirements

Shear adhesion: Pass

Corrosion protection: Pass

Glass transition temperature:  $\geq 68$  °C

Dangerous substances: comply with 5.4

ISOMAT S.A.

BUILDING CHEMICALS AND MORTARS

ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:

17th km Thessaloniki - Ag. Athanasios Road,  
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece,  
Tel.: +30 2310 576 000, Faks: +30 2310 722 475

www.isomat.eu e-mail: info@isomat.eu

Të dhënat teknike dhe udhëzimet që përfshihen në këtë broshurë (fletëpalosje) teknike janë rezultat i njohurive dhe përvijës së sektorit të kërkimeve dhe zhvillimit të ndërmarrjes, si edhe i aplikimit të produktit në vepër. Rekomandimet dhe sugjerimet në lidhje me përdorimin e materialeve jepen pa garanci pasi secili nga kushtet ku ato aplikohen janë jashtë kontrollit të ndërmarrjes sonë. Për këtë arsye mban përgjegjësi përdoruesi për të qenë i sigurt se materiali është i përshtatshëm për aplikimin e parashikuar dhe kushtet konkrete në vepër. Botimi i kësaj broshureje (fletëpalosjeje) teknike anulon çdo botim të mëparshëm për të njëjtin material.

